



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 03/L-090

**MBI PARTNERITETET PUBLIKO PRIVATE DHE KONCESIONET NË
INFRASTRUKTURË DHE PROCEDURAT PËR DHËNIEN E TYRE**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Në pajtim me nenet 121 dhe 160 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në të cilën janë përcaktuar të drejtat e palëve private për marrjen e koncesioneve dhe/ose të drejtat tjera për shfrytëzimin dhe/ose eksplotimit e infrastrukturës publike, ndërmarrjeve publike dhe burimeve publike;

Në pajtim me nenet e sipër cekura 121 dhe 160 të Kushtetutës, kushtet lidhur me koncesionet dhe të drejtat e tjera lidhur me shfrytëzimin dhe/ose eksplotimin e infrastrukturës dhe ndërmarrjeve publike janë përcaktuar në këtë ligj.

Duke parë si të domosdoshme nevojën e pjesëmarrjes së sektorit privat për sigurimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike;

Miraton

**LIGJ MBI PARTNERITETET PUBLIKO PRIVATE DHE KONCESIONET NË
INFRASTRUKTURË DHE PROCEDURAT PËR DHËNIEN E TYRE**

PËRMBAJTJA

TITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1	Qëllimi
Neni 2	Fushëveprimi
Neni 3	Parimet e Përgjithshme
Neni 4	Përkufizimet

TITULLI II PARTNERITETI PUBLIKO-PRIVAT DHE KONCESIONET

Neni 5	Autorizimi për Dhënien e Koncesioneve dhe të Drejtave të Tjera
Neni 6	Autoriteti Kontraktues
Neni 7	Format e Partneritetit
Neni 8	Kohëzgjatja
Neni 9	Pronësia e Aseteve
Neni 10	Të Drejtat Financiare

TITULLI III KOORDINIMI INSTITUCIONAL DHE PËRGJEGJËSITË

Neni 11	Komisioni Drejtues Ndër-Ministror i PPP (KDNM-PPP)
Neni 12	Kompetencat e KDNM-PPP
Neni 13	Njësia PPP
Neni 14	Të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Autoritetit Kontraktues
Neni 15	Të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Partnerit Privat
Neni 16	Të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Shfrytëzuesve të një Objekti të Infrastrukturës
Neni 17	Çështjet Buxhetore për PPP

TITULLI IV IDENTIFIKIMI I PROJEKTEVE POTENCIALE DHE PROCEDURAVE PËR DHËNIEN E KONCESIONEVE DHE PARTNERITETEVE PUBLIKO-PRIVATE

PJESA I Identifikimi i Projekteve Potenciale

Neni 18	Iniciativa e Sektorit Publik
Neni 19	Iniciativa e Sektorit Privat

PJESA II Përzgjedhja e Partnerit Privat

Kreu 1 Parimet e Përgjithshme

Neni 20	Rregullat për procedurën e përzgjedhjes dhe dhënies së Koncesioneve dhe Marrëveshjes
Neni 21	Marrëveshjet e Pavlefshme
Neni 22	Fazat e Përzgjedhjes

Kreu 2 Parakualifikimi dhe Para-përzgjedhja e Ofertuesve

Neni 23	Qëllimi dhe Procedura e Parakualifikimit
Neni 24	Kriteret e para-përzgjedhjes

- Neni 25 Pjesëmarrja e Konsorciumeve
Neni 26 Vendimi mbi para-përzgjedhjen

Kreu 3 Procedurat për Kërkimin e Propozimeve

- Neni 27 Procedurat një-fazëshe dhe dy-fazëshe për kërkimin e propozimeve
Neni 28 Përmbajtja e kërkesës për propozime
Neni 29 Siguria e Ofertës
Neni 30 Sqarimet dhe ndryshimet
Neni 31 Dorëzimi i propozimeve
Neni 32 Kriteret e vlerësimit
Neni 33 Krahasimi dhe vlerësimi i propozimeve
Neni 34 Demonstrimi i mëtejshëm i përmbushjes së kritereve për kualifikim
Neni 35 Negociatat finale

Kreu 4 Negocimi i Marrëveshjeve pa procedura konkurruese

- Neni 36 Rrethanat që autorizojnë dhënien e kontratës pa procedura konkurruese
Neni 37 Procedurat për negociim të marrëveshjeve

Kreu 5 Propozimet e pa kërkuara

- Neni 38 Pranueshmëria e propozimeve të pa kërkuara
Neni 39 Procedurat për konstatim të pranueshmërisë së propozimeve të pa kërkuara
Neni 40 Inicimi i procedurës së përzgjedhjes

Kreu 6 Dispozitat e ndryshme

- Neni 41 Konfidencialiteti
Neni 42 Njoftimi për dhënie të kontratës
Neni 43 Regjistrimi i procedurave të përzgjedhjes dhe dhënies së kontratës
Neni 44 Procedurat e rishikimit

TITULLI V MARRËVESHJA PËR PPP

PJESA 1 Përmbajtja dhe dispozitat e përgjithshme

- Neni 45 Ligji i zbatueshëm
Neni 46 Përmbajtja e marrëveshjes
Neni 47 Pronësia mbi asetet
Neni 48 Përvetësimi i të drejtave që lidhen me lokacionin e projektit
Neni 49 Lehtësimet
Neni 50 Operimi i infrastrukturës
Neni 51 Dispozitat financiare
Neni 52 Organizimi i Partnerit privat
Neni 53 Bartja e interesit kontrollues në Partnerin privat

Neni 54	Interesat e sigurimit
Neni 55	Bartja e marrëveshjes
Neni 56	Ndryshimi i ligjit
Neni 57	Rishikimi i Marrëveshjes
Neni 58	Ndërhyrja e Autoritetit Kontraktues
Neni 59	Zëvendësimi i Partnerit Privat

PJESA 2 Kohëzgjatja, Zgjatja e Afatit dhe Dhënia Fund e Marrëveshjes

Kreu 1 Kohëzgjatja dhe zgjatja e afatit

Neni 60	Kohëzgjatja dhe zgjatja e afatit të Marrëveshjes
---------	--

Kreu 2 Skadimi apo mbarimi i marrëveshjes

Neni 61	Skadimi i marrëveshjes
Neni 62	Përfundimi i parakohshëm i marrëveshjes nga Autoriteti Kontraktues
Neni 63	Përfundimi i parakohshëm i marrëveshjes nga Partneri privat
Neni 64	Përfundimi i parakohshëm për shkaqe të tjera

Kreu 3 Aranzhimet në rast të përfundimit apo skadimit të marrëveshjes

Neni 65	Kompensimi për shkak të dhënies fund marrëveshjes
Neni 66	Masat e përfundimit dhe transferit

PJESA 3 Zgjidhja e Kontesteve

Neni 67	Kontestet ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Partnerit privat
Neni 68	Arbitrazhi
Neni 69	Kontestet që përfshijnë klientët apo shfrytëzuesit e objektit të infrastrukturës

TITULLI VI KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK

Neni 70	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
---------	---

TITULLI VII DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 71	Shfuqizimi i legjislacionit të mëparshëm
Neni 72	Marrëveshjet tanimë të nënshkruara
Neni 73	Implementimi i ligjit
Neni 74	Hyrja në fuqi

TITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të caktoj kornizën ligjore për dhënien e Partneritetit Publik Privat dhe koncesioneve për të ndërtuar, shfrytëzuar, dhe/ose eksploatuar infrastrukturën publike dhe për të ofruar shërbime publike.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Dispozitat e këtij ligji rregullojnë të drejtat për të shfrytëzuar dhe/ose eksploatuar infrastrukturën publike dhe/ose ofrimin e shërbimeve publike në sektorët vijues ekonomik dhe shoqëror:

- 1.1. transport (përfshi sistemin hekurudhor, transporti në binarë, aeroportet, rrugët, tunelet, urat, parkingjet, transporti publik);
- 1.2. gjenerimi dhe distribuimi i energjisë elektrike;
- 1.3. gjenerimi dhe distribuimi i nxehtësisë;
- 1.4. prodhimi, distribuimi, trajtimi, mbledhja, dhe administrimi i ujit, ujërave të zeza, drenazhës, ujitjes, kanaleve, pendave;
- 1.5. mbledhja, transferimi, procedimi dhe administrimi i mbeturinave të ngurta dhe riciklimi;
- 1.6. telekomunikacioni;
- 1.7. arsimit;
- 1.8. sporti dhe rekreacioni;
- 1.9. shëndetësia;
- 1.10. turizmi dhe kultura;
- 1.11. infrastruktura e burgjeve;
- 1.12. rehabilitimi i tokës dhe pyjeve;

- 1.13. parqet industriale;
- 1.14. strehimi publik dhe puna sociale;
- 1.15. ndërtesat qeveritare dhe publike;
- 1.16. punët komunale;
- 1.17. shërbimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës bazë të TI dhe të dhënave; dhe
- 1.18. naftësjellësit, gazsjellësit, rafinerimi dhe distribuimi.

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen vetëm për marrëdhëniet kontraktuese ose ato institucionale në të cilat:

2.1. Partneri Privat ushtron një veprimtari ekonomike e cila përndryshe do të ishte ushtruar nga një Autoritet Publik; dhe

2.2. Partneri Privat i merr përsipër të gjitha ose një pjesë të konsiderueshme të rrezikshmërisë që është e lidhur me veprimtarinë ekonomike të lartpërmendur.

3. Ky ligj nuk do të zbatohet për dhënien e licencave, përveç deri në shkallën kur licenca është lëshuar në kuadër të një koncesioni ose marrëveshjeje për partneritetin Publiko-Private.

4. Ky ligj nuk do të zbatohet për privatizimin ose heqjen e të drejtës së një infrastrukture publike ose ndërmarrje publike.

5. Ky ligj nuk do të zbatohet për miniera, minerale, të drejta nëntokësore dhe nuk do të zbatohet për të drejtat e hapësirës ajrore.

6. Qeveria përmes Ministrisë të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, në cilësi të përfaqësuesit të KDNM-PPP, do të përgatisë raport vjetor rreth Koncesioneve dhe Partneriteteve Publike Private dhe do të paraqesin atë Kuvendit të Republikës së Kosovës. Raporti vjetor duhet të përmbaj informata të detajuara së paku sa i përket çështjeve në vazhdim:

6.1. aktivitetet të ndërmarra dhe politikave të aprovuara nga KDNM-PPP gjatë vitit paraprak;

6.2. statusit aktual të Projekteve të PPP-ve dhe Koncesioneve, duke përfshirë këtu edhe ato projekte të dhëna në bazë të procedurave ligjore dhe ato që priten të ipen në dymbëdhjetë (12) muajt e ardhshëm;

6.3. regjistrin kombëtar të aseteve të koncesionit dhe PPP-ve; dhe

6.4. përkrahja ekonomike dhe detyrimet kontingjente që rrjedhin nga Projektet me PPP dhe Koncesione.

7. Në nivelin komunal, kryetarët e komunave paraqesin raport vjetor rreth koncesioneve dhe Partneriteteve Publike Private Kuvendeve Komunale. Raporti i vjetor duhet të përmbaj informata të detajuara sa i përket çështjeve në vazhdim:

7.1. të gjitha aktivitetet e PPP-ve dhe Koncesioneve të ndërmarra nga komuna gjatë vitit paraprak;

7.2. statusit aktual të projekteve relevante të komunës me PPP dhe koncesione, duke përfshirë këtu edhe ato projekte të dhëna në bazë të procedurave ligjore dhe aty që priten të ipen në dymbëdhjetë (12) muajt e ardhshëm;

7.3. regjistrin komunal të aseteve të koncesionit dhe PPP-ve; dhe

7.4. përkrahja ekonomike dhe detyrimet kontingjente që rrjedhin nga projektet komunale me PPP dhe koncesione.

Neni 3 Parimet e Përgjithshme

Dispozitat e këtij ligji i nënshtrohen parimit të trajtimit të barabartë, mos-diskriminimit, transparencës, proporcionalitetit, ekonomikitetit, efikasitetit, mbrojtjes së interesave publike, konkurrencës së lirë dhe Vlerës-për-Paranë.

Neni 4 Përkufizimet

Për qëllime të këtij ligji,

“Marrëveshje” do të thotë një kontratë e koncesionit, një kontratë për partneritet publiko-privat, ose një marrëveshje institucionale e cila është rrjedhë nga një Partneritet-Publiko-Privat, sikur që është përkufizuar në këtë ligj.

“Ofertues” ose **“Ofertuesit”** do të thotë personat juridik, duke përfshirë grupet e personave juridik, të cilët janë pjesëmarrës në një procedurë të përzgjedhjes për një Marrëveshje të PPP.

“Koncesion” do të thotë një e drejtë e veçantë e cila i epet një Partneri Privat nga një Autoritet Publik me qëllim të sigurimit, operimit dhe mirëmbajtjes së një infrastrukture ekzistuese për një periudhë të caktuar kohore. Partneri Privat merr përsipër rrezikshmëri të konsiderueshme ekonomike, ndërsa sektori publik mbanë pronësinë ndaj aseteve fillestare. Shembuj të kësaj janë, ndër tjera: (i) Rehabilitimi, Operimi dhe Bartja (ROB); (ii) Rehabilitimi, Qiradhënia dhe Bartja (RQB); dhe (iii) Ndërtimi, Rehabilitimi, Operimi dhe Bartja (NROB). Koncesionet dallojnë nga Projektet Greenfield pasi që këto të fundit kanë të bëjnë me Infrastrukturë të re dhe jo ekzistuese.

“Konsorcium” do të thotë një grup i operatorëve ekonomik.

“Autoritet Kontraktues” do të thotë Autoritetin Publik i cili ka autorizimin ligjor për hyrjen në një koncesion ose lidhjen e një Marrëveshje PPP.

“Përkrahja Ekonomike” nënkupton mekanizmat financiar të cilat ofrohen nga Autoriteti Kontraktues dhe/ose Ministria e Ekonomisë dhe Financave me qëllim të sigurimit të zbatueshmërisë, mundësisë, dhe/ose qëndrueshmërisë financiare të një Projekti për PPP, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 10 të këtij ligji.

“Projektet Greenfield” ose **“PPP Greenfield”** i referohen një forme të PPP-ve dhe do të thotë një Projekt në të cilin Partneri Privat ose një ndërmarrje me financim të përzier publiko-privat, ndërton, dhe operon një objekt të ri ose të zgjeruar gjatë periudhës së përcaktuar në Marrëveshje. Projektet Greenfield mund të përfshijnë, përveç tjerash, edhe këto lloje të marrëveshjeve kontraktuese: (i) Ndërtimi, qiradhënia, dhe bartja (NQB); (ii) Ndërtimi, operimi dhe bartja (NOB), (iii) Ndërtimi, pronësia dhe operimi (NPO), dhe (iv) Projektimi- Ndërtimi-Financimi-Bartja (PNFB), dhe (v) Projektimi-Ndërtimi-Financimi-Operimi (PNFO).

“Objektet e Infrastrukturës” do të thotë asetet fizike dhe sistemet të cilat drejtpërdrejtë ose tërthorazi sigurojnë shërbime për publikun.

“PPP Institucionale” do të thotë një ndërmarrje e përbashkët (ndërmarrje me kapital të përzier) ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Partnerit Privat me ç’rastë të dy palët bashkërisht zotërojnë aksione në një person juridik, qëllimi i vetëm i të cilit është sigurimi i infrastrukturës ose shërbimeve përkatëse.

“Partner Privat” nënkupton personin juridik i cili hyn në një Marrëveshje të PPP me Autoritetin Kontraktues për sigurimin e infrastrukturës dhe shërbimeve.

“Projekt” ose **“Projekt PPP”** do të thotë secilin nga aktivitetet në vijim ose cilindo kombinim, sikur: projektimi, ndërtimi dhe zhvillimi i objekteve të reja të infrastrukturës, rehabilitimi, modernizimi dhe zgjerimi i objekteve ekzistuese të infrastrukturës; administrimi, zgjerimi ose shërbimet tjera lidhur me objektet e reja ose ekzistuese të infrastrukturës.

“Autoritet Publik” do të thotë secilën nga vijueset: (i) një autoritet, organ publik, ministri, departament, agjenci ose autoritet tjetër qendror, rajonal, komunal ose ekzekutiv i cili, në bazë të një ligji ose akti nën-ligjor, ushtron kompetenca ekzekutive, legjislativë, rregullative, administrative-publike ose gjyqësore, (ii) një organ i cili rregullohet sipas ligjit publik; dhe (ii) dhe përfshin (ii) departamentet apo pjesët ose nën-njësitë e këtij organi apo autoriteti publik; dhe (ii) një bashkim të një ose më shumë autoriteteve ose organeve të lartpërmendura.

“Partneriteti Publiko-Privat” ose **“PPP”** do të thotë çfarëdo formë e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve publike dhe sektorit privat i cili përfshinë ndarjen e rrezikut me qëllim të sigurimit të financimit, ndërtimit, riparimit, menaxhimit, operimit dhe/ose mirëmbajtjen e një infrastrukture dhe/ose sigurimin e një shërbimi. PPP-ja do t’i referohet Koncesioneve, Projekteve Greenfield, dhe/ose cilido kombinim nga kjo.

“Punët Komunale” nënkuptojnë asetet infrastrukturore dhe shërbimet komunale të shkallës më të ulët, siç janë të përkufizuara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.

“Komisioni Drejtues Ndër-Ministror i Partneriteteve Publiko-Private” ose **“KDNM-PPP”** do ta ketë kuptimin e caktuar në nenin 11 të këtij ligji.

“Njësia e Partneriteteve Publiko-Private” ose **“Njësia PPP”** do të ketë kuptimin e caktuar në nenin 13 të këtij ligji.

“Organi Shqyrtues i Prokurimit” ose **“OSHP”** do të thotë Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik të themeluar në Pjesën VII në Ligjin për Prokurimin Publik.

“Propozim i Pa-kërkuar” do të thotë çdo propozim për një Projekt të PPP i cili nuk është dorëzuar si përgjigje ndaj një kërkesë të një Autoriteti Publik në kuadër të një procedurë konkurruese të përzgjedhjes.

“Vlera për Paratë” do të thotë përfitimi marginal ekonomik dhe social i nxjerrë nga shfrytëzimi i PPP-së në vend të ofrimit të pastër publik të infrastrukturës dhe shërbimeve të specifikuar. Vlera për para është e kalkuluar mbi baza të neto vlerës aktuale të pritur të Projektit që lidhet me krahasuesin e sektorit publik. Kalkulimi i vlerës për para nuk do t’i referohet vetëm çmimit ose kostos të mallrave ose shërbimeve, mirëpo edhe me cilësinë, efikasitetin, afatet e sigurimit si dhe faktorët tjerë të cilët ndikojnë në përcaktimin e vlerës më të favorshme ekonomike nga mundësitë e ofruara.

TITULLI II

PARTNERITETI PUBLIKO-PRIVAT DHE KONCESIONET

Neni 5

Autorizimi për Dhënien e të drejtave për Partneritetet-Publiko Private dhe Koncesione

Të drejtat për shfrytëzimin dhe/ose eksplotimin e infrastrukturës publike dhe/ose sigurimin e shërbimeve publike mund të jepen në përputhje me këtë ligj në cilindo sektor ekonomik ose shoqëror të identifikuar në paragrafin 1. të nenit 2 të këtij ligji.

Neni 6

Autoriteti Kontraktues

1. Partneritetet Publiko-Private dhe Koncesionet epen nga Autoriteti Publik i cili, në bazë të ligjit është drejtpërdrejtë përgjegjës për veprimtarinë ekonomike e cila është objekt i Marrëveshjes.

2. Kur një Projekt i Partneritetit Publiko-Privat ose Koncesionit përfshinë infrastrukturën dhe/ose shërbimet të cilat janë nën përgjegjësinë e më shumë se një Autoriteti Publik, KDNM-PPP do të identifikojë Autoritetin ose Autoritet Kontraktuese përgjegjëse për Marrëveshjen përkatëse.

3. Në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji dhe me miratimin paraprak të Qeverisë, KDNM-PPP gjithashtu është e autorizuar që të veprojë në cilësinë e një Autoriteti Kontraktues dhe të ep koncesione dhe të drejta tjera për PPP-në për ndërtimin, shfrytëzimin dhe/ose eksplotimin e një Objekti të Infrastrukturës Publike.

Neni 7

Format e Partneritetit

1. Marrëveshjet mund të zbatohen qoftë përmes arranzhimeve kontraktuese ose institucionale.
2. Partneritetet Publiko-Private mund të përfshijnë cilindo nga veprimtaritë në vijim ose cilindo kombinim të tyre si:
 - 2.1. projektimi, ndërtimi, financimi, mirëmbajtja dhe operimi i objekteve të reja të infrastrukturës;
 - 2.2. riparimi, modernizimi, financimi, zgjerimi, mirëmbajtja dhe operimi i objekteve ekzistuese të infrastrukturës; dhe/ose
 - 2.3. administrimi, menaxhimi, operimi, mirëmbajtja ose shërbimet tjera që kanë të bëjnë me objektet e reja ose infrastrukturën ekzistuese.
3. Autoriteti Kontraktues do të zgjedhë mënyrën kontraktuese ose institucionale e cila pasqyron më së miri ndarjen e dëshiruar të rrezikshmërisë dhe përgjegjësi për secilën marrëveshje. Mënyrat kontraktuese mund të përfshijnë, përveç tjerash, Kontratat e Menaxhimit, Marrëveshjet për Qiradhënie-Zhvillim-Operim, Koncesionet, Marrëveshjet për Projektim-Ndërtim-Financim-Operim-Bartje, strukturat Ndërtim-Zotërim-Operim si dhe çdo strukturë tjetër kontraktuese e cila i bartë Partnerit Privat një shkallë të caktuar të rrezikshmërisë ekonomike dhe/ose të performancës lidhur me sigurimin e infrastrukturës ose shërbimeve publike.
4. Ky ligj nuk do të zbatohet për kontratat e shërbimit ose kontratat e punëve, sikur që janë të përkufizuara në Ligjin për Prokurim Publik.

Neni 8

Kohëzgjatja

1. Kohëzgjatja e një Koncesioni ose Partneriteti Publik-Privat do të përcaktohet në Marrëveshjen gjegjëse, mirëpo në asnjë rast nuk duhet të jetë më shumë se katërdhjetë (40) vite nga data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes.

2. Përjashtimisht nga paragrafi 1. i këtij neni dhe në pajtim me paragrafin 3. të nenit 60 të këtij ligji, Autoriteti Kontraktues mund të pajtohet që të zgjasë kohëzgjatjen e Marrëveshjes për një periudhë shtesë e cila nuk mund të tejkaloj më shumë se $\frac{1}{4}$ (një të katërtën) e kohëzgjatjes fillestare të caktuar në Marrëveshje.

3. Përveç Marrëveshjeve të formalizuara nga qeveritë komunale, KDNM-PPP duhet të autorizoj çfarëdo zgjatje që jepet në bazë të paragrafit 2 të këtij neni.

Neni 9 Pronësia e Aseteve

Gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes, Autoriteti Kontraktues mundet që përkohësisht t'ia bartë Partnerit Privat pronësinë mbi Objektivin e Infrastrukturës dhe asetet tjera publike të cilat drejtpërdrejt ndërlidhen me objektin e Marrëveshjes, të cilat duhet t'i kthehen Autoritetit Kontraktues pas skadimit ose ndërprerjes së Marrëveshjes.

Neni 10 Të Drejtat Financiare

1. Partneri Privat ka të drejtë të vendosë, pranojë ose mbledhë tarifa ose ngarkesa për shfrytëzimin e objektit ose shërbimeve të tij në përputhje me kushtet e përcaktuara në Marrëveshje, e cila gjithashtu duhet të përmbajë metodat dhe formulat për përcaktimin dhe rregullimin e këtyre tarifave ose ngarkesave, në përputhje me rregullat e vendosura nga Autoriteti kompetent Publik.

2. Kur në mënyrë të përshtatshme është e arsyeshme dhe kërkohet në bazë të zbatueshmërisë financiare, mundësisë, dhe pas miratimit paraprak të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe KDNM-PPP, Autoriteti Kontraktues mund të sigurojë përkrahje ekonomike për të siguruar qëndrueshmëri, zbatueshmëri, dhe/ose mundësi financiare të Projektit. Kjo përkrahje ekonomike duhet të identifikohet paraprakisht në dokumentin e Kërkesës për Propozime dhe/ose të jetë faktor në vlerësimin e propozimeve. Përkrahja ekonomike mund të bëhet në çfarëdo forme të arsyeshme, duke përfshirë:

2.1. bërjen e pagesave të drejtpërdrejta për Partnerin Privat si zëvendësim për, ose si plotësim i tarifave për shfrytëzimin e objektit/pajisjes ose shërbimeve. Këtu përfshihen pagesat e disponueshme, subvencionet, grantet kapitale, garantimi minimal i trafikut, garantimi i të ardhurave, si dhe marrëveshjet e shitjes dhe blerjes;

2.2. kontributet në natyrë, duke përfshirë bartjen e asetëve dhe të drejtave për shfrytëzimin e tokës; dhe

2.3. përkrahjet tjera financiare dhe garancitë të natyrës së ngjashme.

3. Autoriteti Kontraktues mundet gjithashtu t'i sigurojë kompensim Partnerit Privat në rast se gjendja e tij financiare ndikohet negativisht dhe materialisht nga ndryshime të paparashikuara në legjislacionin ose rregulloret të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në Objektivin e Infrastrukturës ose sigurimin e shërbimit përkatës.

4. Partneri Privat ka të drejtë ta ulë çmimin e vlerës së investimeve të tij kapitale në Objektivin e Infrastrukturës me përdorimin e një metode të njëtrajtshme të uljes së çmimit (zhvlerësimit) gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes.

TITULLI III

KOORDINIMI INSTITUCIONAL DHE PËRGJEGJËSITË

Neni 11

Komisioni Drejtues Ndër-Ministror i PPP (KDNM-PPP)

1. Komisioni Drejtues Ndër-Ministror për Partneritetet Publiko-Private ("KDNM-PPP") do të themelohet për kontrollimin dhe koordinimin e Projekteve të PPP në të gjithë sektorët ekonomik dhe shoqëror.

2. KDNM-PPP përbëhet nga këta anëtarë të përhershëm:

2.1. Ministri i Ekonomisë dhe Financave;

2.2. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë;

2.3. Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;

2.4. një (1) përfaqësues i emëruar nga Zyra e Kryeministrit, emërimi i të cilit do të konfirmohet dhe do të hyjë në fuqi me një vendim formal të Qeverisë

3. Gjithashtu, përfaqësuesi më i lartë i cilitdo Autoritet Publik i cili ka një interes të drejtpërdrejtë në një projekt të caktuar PPP, prokurim ose Marrëveshje të PPP do të shërbejë ex officio si anëtar i përkohshëm i KDNM-PPP gjatë shqyrtimit të çështjeve që ndërliken drejtpërdrejtë me projektin, prokurimin ose Marrëveshjen përkatëse të PPP.

4. Ministri i Ekonomisë dhe Financave e drejton dhe koordinon veprimtarinë e KDNM-PPP si dhe shërben në cilësinë e kryesuesit të saj.

Neni 12

Kompetencat e KDNM-PPP

1. KDNM-PPP e ka rolin udhëheqës për zhvillimin e politikave dhe programeve të PPP dhe i përgatitë rekomandimet për Qeverinë e Kosovës me qëllim që të njëjtat t'i shqyrtojë dhe miratojë.
2. KDNM-PPP i ka këto të drejta dhe përgjegjësi:
 - 2.1. menaxhimin e programit kombëtar të PPP;
 - 2.2. zhvillimin e politikave të përgjithshme të PPP;
 - 2.3. nxjerrjen e rregulloreve të zbatimit lidhur me rregullat dhe standardet për Projektet e PPP si dhe dokumentet e projektit;
 - 2.4. shqyrtimin dhe miratimin ose refuzimin e Propozim-Projekteve në bazë të parimit të Vlerës për Para si dhe faktorëve të tjerë;
 - 2.5. identifikimin e Autoriteteve Kontraktuese për Projektet e caktuara;
 - 2.6. veprimin në cilësinë e Autoritetit Kontraktues për Projekte të caktuara;
 - 2.7. miratimin ose refuzimin e Përkrahjes Ekonomike për Projektet;
 - 2.8. mbikëqyrjen dhe shqyrtimin e performancës së përputhshmërisë dhe ekzekutimit të projektit;
 - 2.9. shqyrtimin dhe miratimin e propozim ndryshimeve dhe plotësimeve në Marrëveshje në bazë të parimit Vlera për Paranë dhe faktorëve të tjerë;
 - 2.10. mbajtjen e një regjistri kombëtar të aseteve të koncesionit;
 - 2.11. marrjen e vendimeve lidhur me shfrytëzimin e fondeve nga ndarjet buxhetore për PPP; dhe
 - 2.12. marrjen e vendimeve tjera të rëndësishme lidhur me PPP.
3. Të gjitha Autoritetet Publike kanë të drejtë që të bëjnë rekomandime për KDNM-PPP lidhur me zhvillimin e politikave dhe direktivave dhe KDNM-PPP është e detyruar që t'i marrë parasysh këto rekomandime para marrjes së vendimit.
4. Në rast se një projekt përfshin bartjen e të drejtave të cilat janë nën kompetencën e më shumë se një Autoriteti Publik, KDNM-PPP do të identifikojë Autoritetin ose Autoritetet Kontraktuese për Marrëveshjen përkatëse dhe të vendosë procedurat për koordinimin e përgjegjësiave.

5. KDNM-PPP është i autorizuar që të parandalojë një Autoritet Kontraktues nga nxjerrja e një kërkesë dhe/ose formalizimi i një Marrëveshje për një projekt e cili nuk është në përputhje me parimin vlera-për-paratë ose që nuk i përmbush standardet minimale të përcaktuara nga Njësia e PPP. Ky autoritet gjithashtu do të aplikohet për të gjitha projektet që përfshinë rehabilitimin e tokës dhe pyjeve, siq është parashikuar në Nenin 2.1, pika (I). Ky autoritet I KDNM-PPP, nuk do të vlejë për projektet PPP që përfshijnë Punët Komunale, përveç nëse projekti në fjalë përfshinë Përkrahje Ekonomike, Garancione buxhetore dhe/ose detyrime kontigjente me vlerë më të madhe se 5% e buxhetit vjetor të komunës në fjalë, për vitin në të cilin Projekti është tenderuar dhe/ose është kontraktuar.

6. KDNM-PPP do të këshillohet dhe përkrahet në ushtrimin e funksioneve të saj nga Njësia e PPP e cila është një sekretari teknike e themeluar në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave sipas Nenit 13 të këtij ligji.

Neni 13 **Njësia PPP**

1. Njësia qendrore e Partneritetit-Publiko-Private themelohet në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për ta ndihmuar KDNM-PPP dhe Autoritetet Publike në të gjitha veprimtaritë që ndërlidhen me PPP. Detyrat primare të njësisë përfshijnë:

1.1. sigurimin e mbështetjes dhe ndihmës teknike për Autoritetet Kontraktuese dhe KDNM-PPP në të gjitha çështjet që janë të lidhura me PPP;

1.2. përgatitjen e rekomandimeve lidhur me kornizën ligjore, rregullatore, institucione dhe të politikave të PPP;

1.3. përgatitjen dhe shpalljen e procedurave dhe praktikave të mira të standardizuara;

1.4. shqyrtimin dhe nxjerrjen e opinioneve lidhur me qëndrueshmërinë e propozim-projekteve si dhe përgatitjen e rekomandimeve për KDNM-PPP dhe Autoritetet Kontraktuese;

1.5. përhapjen e informatave lidhur me programin PPP dhe projektet individuale;

1.6. përfshirjen e akterëve dhe fushatat publike të edukimit për PPP;

1.7. këshillimin dhe asistimin e KDNM-PPP në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me PPP;dhe

1.8. në përgjithësi bënë koordinimin e aktiviteteve lidhur me PPP në të gjithë sektorët ekonomik dhe shoqëror.

2. Detyrat e përgjithshme të Njësisë PPP përfshijnë:

- 2.1. kërkimin nga Autoritetet Publike që të sigurojnë detale në lidhje me projektet që propozohen, që përgatiten për tenderim, që u jepen tenderuesve apo negociohen, apo që janë në proces drejt zbatimit;
 - 2.2. nxjerrjen e standardeve dhe praktikave të rekomanduara për PPP;
 - 2.3. përgatitjen dhe shpërndarjen e informatave dhe udhëzimeve për PPP;
 - 2.4. nxjerrjen e dokumenteve të standardizuara me qëllim të harmonizimit të procedurave të tenderimit dhe marrëveshjeve;
 - 2.5. paraqitjen e propozimeve në KDNM-PPP për fuqizimin e kornizës legislative, rregullatore, institucionale dhe të politikave të PPP;
 - 2.6. koordinimin e asistencës teknike për Autoritetet relevante Kontraktuese;
 - 2.7. shqyrtimin e projekt-propozimeve, tenderëve dhe kontratave, si dhe sistemeve të qeverisjes së kontratës;
 - 2.8. monitorimin dhe lëshimin e mendimeve lidhur me nivelin e përputhshmërisë së Autoritetit Kontraktues dhe Partnerit Privat me kushtet e Marrëveshjes; dhe
 - 2.9. lëshimin e mendimeve teknike për KDNM-PPP dhe Autoritetet kontraktuese.
3. Me qëllim të sigurimit që pozitave kyçe në Njësinë për PPP të plotësohen me profesionistë të kualifikuar, Ministria e Ekonomisë dhe Financave mund të prokurorë shërbimet e ekspertëve të jashtëm profesional dhe/ose teknik për plotësimin e këtyre pozitave, me përdorimin e mjeteve nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, të ardhurat e dedikuara ose burimet e jashtme të financimit.

Neni 14

Të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Autoritetit Kontraktues

1. Autoriteti Kontraktues i gëzon të gjitha të drejtat e përcaktuara në Marrëveshje, duke përfshirë por pa u kufizuar, në të drejtën për kontrollimin e arsyeshëm të veprimtarisë së Partnerit Privat si dhe për të siguruar përputhshmërinë rigoroze me kushtet e Marrëveshjes.
2. Autoriteti Kontraktues duhet në mënyrë rigoroze t'i përmbush kushtet e Marrëveshjes si dhe detyrimet e tij të përcaktuara në Marrëveshje. Përgjegjësitë tjera të Autoritetit Kontraktues përfshijnë:
 - 2.1. Realizimin e aktiviteteve përgatitore për një projekt të mundshëm, duke përfshirë të gjitha studimet përkatëse të fizibilitetit dhe opsioneve, modeleve financiare, analizën

vlera-për-paranë si dhe studimet tjera të nevojshme për strukturimin e një Projekti të qëndrueshëm teknikisht dhe financiarisht;

2.2. dorëzimin e propozim-Projekteve dhe kërkesave për Mbështetje Financiare për miratim nga KDNM-PPP dhe/ose Njësia e PPP, në përputhje me këtë ligj dhe udhëzimet pasuese;

2.3. themelimi i një ekipi të kualifikuar për menaxhimin e projektit për mbikëqyrjen e procesit të transaksioneve, sipas nevojës;

2.4. përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe specifikimeve sipas rregullave të zbatueshme;

2.5. zbatimin e procesit të prokurimit dhe përzgjedhjen e Partnerit Privat;

2.6. themelimin e një strukture efektive dhe transparente të qeverisjes për monitorimin dhe zbatimin (detyrimin) e përputhshmërisë nga të gjitha palët me kushtet e Marrëveshjes.

2.7. sigurimin e informatave, të cilat kërkohen me arsye, nga KDNM-PPP dhe NJPPP; dhe

2.8. koordinimin e aktiviteteve dhe përputhshmërisë me udhëzimet e nxjerra nga KDNM-PPP.

3. Kompetenca rregullative për Marrëveshjet e PPP do tu besohet trupave funksionalisht të pavarura me një nivel të mjaftueshëm të autonomisë për të garantuar se vendimet e tyre merren pa ndërhyrje politike apo pa presion të pavend nga operuesit e infrastrukturës, ofruesit e shërbimeve publike apo nga palët e përfshira në Marrëveshje.

4. Vetëm nëse përcaktohet ndryshe në Marrëveshje, Autoriteti Kontraktues do të duhet të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e Partnerit Privat dhe të garantoj pajtueshmëri rigoroze me kushtet e Marrëveshjes.

Neni 15

Të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Partnerit Privat

1. Partneri Privat i gëzon të gjitha të drejtat e përcaktuara në Marrëveshje, duke përfshirë por pa u kufizuar, në të drejtën për shfrytëzimin dhe/ose eksplotimin e Objektivit të Infrastrukturës në përputhje me kushtet e përcaktuara në Marrëveshje.

2. Partneri Privat duhet që në mënyrë rigoroze t'i plotësojë kushtet e përcaktuara në Marrëveshje dhe me besnikëri t'i përmbush detyrat e përcaktuara në Marrëveshje.

Neni 16

Të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Shfrytëzuesve të një Objekti të Infrastrukturës

1. Publiku do të ketë qasje në infrastrukturën dhe shërbimet në baza jo-diskriminuese si dhe do të ketë të drejtë të marrë shërbime cilësore dhe të vazhdueshme me çmime të arsyeshme.
2. Kur kërkohet sipas kushteve të Marrëveshjes, publiku duhet të paguajë tarifa ose ngarkesa për shfrytëzimin e objektit ose shërbimeve të tij.

Neni 17

Çështjet Buxhetore për PPP

1. Autoriteti ose Autoritetet Kontraktuese janë drejtpërdrejt përgjegjëse për çfarëdo ndarje buxhetore që nevojiten për zbatimin dhe mbikëqyrjen e një Projekti.
2. Me qëllim të plotësimit të financimit nga Buxheti i Republikës së Kosovës si dhe me qëllim të mbledhjes së të ardhurave vetanake për Njësinë PPP, KDNM-PPP mund të kërkojë që disa ose të gjitha Marrëveshjet të përcaktojnë tarifa të cilat duhet të paguhet nga Partnerët Privat me qëllim të kompensimit të pjesshëm ose të plotë të shpenzimeve të Njësisë PPP, këtu përfshihet:
 - 2.1. **Tarifa e Transaksionit:** KDNM-PPP mund të kërkojë pagimin e një tarife të transaksionit nga Partneri Privat me qëllim të kompensimit të pjesshëm ose të plotë të shpenzimeve që ndërlidhen me transaksionin në fjalë si dhe për të siguruar burime të mjaftueshme financiare për monitorimin e përputhshmërisë me kushtet e Marrëveshjes. Shuma e tarifave të transaksionit, si dhe kushtet lidhur me pagimin e këtyre tarifave, duhet të përcaktohen në dokumentet e kërkesës për propozime. Pagimi i tarifës së transaksionit konsiderohet detyrim i pa-negociueshëm dhe i detyrueshëm i Ofertuesit të zgjedhur.
 - 2.2. **Tarifa e Mbikëqyrjes:** KDNM-PPP mund të kërkojë nga Partneri Privat pagimin e një tarife të mbikëqyrjes, qoftë vetëm një herë ose në bazë vjetore, me qëllim të kompensimit të pjesshëm ose të plotë të shpenzimeve që ndërlidhen me monitorimin e përputhshmërisë së të gjitha palëve me Marrëveshjen PPP. Shuma e tarifave të mbikëqyrjes, si dhe kushtet lidhur me pagimin e këtyre tarifave, duhet të përcaktohen në dokumentet e kërkesës për propozime. Pagimi i tarifës së transaksionit konsiderohet detyrim i pa-negociueshëm dhe i detyrueshëm i Partnerit Privat.
3. Në përputhje me Ligjin Vjetor për Ndarjet Buxhetore dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të hyrat vetanake dhe grantet e caktuara të Njësisë PPP mund të shfrytëzohen për financimin e veprimtarisë së Njësisë PPP, duke përfshirë angazhimin e personelit.
4. Fondet e ndara për Njësinë PPP do të shpenzohen nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave e cila vepron në emër të KDNM-PPP.

5. Zgjedhja e këshilltarëve të kualifikuar të cilët financohen nga buxheti i Njesisë PPP do të realizohet në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik.

TITULLI IV

IDENTIFIKIMI I PROJEKTEVE POTENCIALE DHE PROCEDURAVE PËR DHËNIEN E KONCESIONEVE DHE PARTNERITETEVE PUBLIKO-PRIVATE

PJESA I

Identifikimi i Projekteve Potenciale

Neni 18

Iniciativa e Sektorit Publik

1. Identifikimi i Projekteve Potenciale do të bëhet nga Autoriteti Kompetent Publik, një Autoritet Publik, KDNM-PPP ose Njësia e PPP.
2. Para tenderimit, Autoriteti Kontraktues duhet të bëjë një studim të fizibilitetit të projektit si dhe një analizë të qëndrueshmërisë dhe pranuarshmërisë bankare për të vendosur se a duhet të zbatohet Projekti. Kjo analizë duhet të bazohet në parimet e vlera-për-paratë, objektivat strategjike të sektorit, fizibilitetin teknik dhe komercial të projektit potencial si dhe aftësinë e projektit për tërheqjen e partnerëve potencial privat dhe financimit privat.
3. Nëse Koncesioni ose Partneriteti Publiko-Privat i propozuar nuk i plotëson kriteret e arsyeshme për vërtetimin e fizibilitetit dhe vlerës-për-paranë të Projektit, atëherë Autoritetit Kontraktues nuk do ti lejohet që të vazhdojë me tenderimin e projektit sipas këtij ligji.
4. Njësia e PPP dhe KDNM-PPP është kompetente për shqyrtimin e studimeve të identifikuara të këtyre çështjeve dhe nëse me arsye kërkohet të insistojnë në kryerjen e studimeve shtesë, qoftë nga Autoriteti Kontraktues ose nga Njësia e PPP para nxjerrjes së vendimit se a është një projekt i autorizuar për tu proceduar për tenderim.
5. Me përjashtim të Projekteve të identifikuara në paragrafin 5. të nenit 12 që përfshijnë Punët Komunale pa Përkrahje Ekonomike, Garancione Buxhetore dhe/ose detyrime kontigjente me vlerë më të madhe se 5% e buxhetit vjetor të komunës në fjalë, të gjitha projektet PPP duhet të kenë një aprovim formal të shkruar nga KDNM-PPP para se të vazhdohet me tender. Autorizimi i përmendur do të epet ose refuzohet në bazë të shqyrtimit teknik të studimit të fizibilitetit të shkallës investuese dhe dokumenteve tjera të ndërlidhura të Projektit, si dhe në bazë të rekomandimeve të bëra nga Njësia e PPP në lidhje me draft dokumentet e tenderit.

Neni 19
Iniciativa e Sektorit Privat

Koncesionet dhe Partneritetet Publiko-Private potenciale munden gjithashtu të identifikohen nga sektori privat përmes propozimeve të pa kërkuara, në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 36 të këtij ligji.

PJESA II
Përzgjedhja e Partnerit Privat

KREU I
Parimet e Përgjithshme

Neni 20
Dispozitat që rregullojnë procedurat e përzgjedhjes dhe dhënies

Përzgjedhja e Partnerit Privat do të kryhet në pajtueshmëri me nenet nga 22 deri në 44 të këtij ligji.

Neni 21
Marrëveshjet e Pavlefshme

1. Nëse Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) konstaton se një Marrëveshje është dhënë nga një Autoritet Kontraktues në kundërshtim me këtë ligj, atëherë kjo kontratë është e pavlefshme dhe e pa zbatueshme. OSHP-ja mund të vendos nëse një kontratë e tillë është e vlefshme dhe e zbatueshme nëse:

1.1. kontrata tashmë është realizuar në tërësi apo pjesërisht; dhe

1.2. duke marrë parasysh pasojat e mundshme për të gjitha interesat të cilat kanë gjasë të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik, vendos se pasojat negative i tejkalojnë përfitimet të cilat mund të arrihen. Në raste të këtilla, OSHP-ja duhet ta ketë autoritetin që të ndërmerr të gjitha masat të cilat i konsideron të nevojshme për të siguruar që Autoriteti përkatës Kontraktues pas kësaj t'i zbatojë detyrimisht kërkesat e këtij ligji.

Neni 22

Fazat e Përzgjedhjes

Partneri Privat do të përzgjidhet përmes një procedure të para kualifikimit, paralelisht me një procedurë për paraqitjen e propozimeve, sipas neneve 23 deri 44 të këtij ligji.

KREU II

Parakualifikimi dhe Para-përzgjedhja e Ofertuesve

Neni 23

Qëllimi dhe Procedura e Parakualifikimit

1. Pasi që KDNM-PPP të ketë aprovuar projektin dhe autorizon fillimin e procedurës tenderuese në pajtim me paragrafin 18.5, Autoriteti Kontraktues do të zhvillojë një procedurë të para-përzgjedhjes e cila ka për qëllim identifikimin e Ofertuesve të cilët i posedojnë kualifikimet e përshtatshme për zbatimin e suksesshëm të projektit të PPP.

2. Ftesa për pjesëmarrje në procedurën e para-përzgjedhjes do të publikohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurim Publik dhe duhet që ofertuesve tu lejohet kohë e mjaftueshme për përgatitjen dhe dorëzimin e aplikacioneve të tyre.

3. Ftesa për pjesëmarrje në procedurën e para-përzgjedhjes duhet të përmbajë së paku, si vijon:

3.1. një përshkrim të Objektivit të Infrastrukturës;

3.2. të dhënat mbi elementet e tjera thelbësore të projektit, siç janë shërbimet të cilat duhet të sigurohen nga Partneri Privat, masat themelore të performancës si dhe aranzhimet financiare të parashikuara nga Autoriteti Kontraktues;

3.3. kur tashmë janë të njohura, një përmbledhje të kushteve kryesore të Marrëveshjes së propozuar;

3.4. mënyrën dhe kohën për dorëzimin e aplikacionit për para-përzgjedhje, duke përfshirë afatet e dorëzimit, të shprehura në data dhe kohë të saktë; dhe

3.5. mënyrën dhe vendin për kërkimin e dokumenteve të para-përzgjedhjes.

4. Përveç pikave të sipërme, dokumentet e para-përzgjedhjes duhet të përfshijnë së paku këto të dhëna:

4.1. kriteret e para-përzgjedhjes në përputhje me nenin 24 të këtij ligji;

4.2. nëse Autoriteti Kontraktues ka për qëllim të heqë dorë nga kufizimet e përcaktuara në këtë ligj për pjesëmarrjen e konsorciumeve;

4.3. nëse Autoriteti Kontraktues ka për qëllim të kërkojë vetëm nga një numër i caktuar i ofertuesve që të paraqesin propozimet e tyre pas përfundimit të procedurës së para-përzgjedhjes sipas paragrafi 2. të nenit 26 të këtij ligji, dhe, sipas rastit, mënyrat në të cilët do të bëhet përzgjedhja;

4.4. periudhën e propozuar kohore për procedurën e tenderimit; dhe

4.5. kushtet e inkorporimit për Ofertuesin e suksesshëm.

Neni 24

Kriteret e para-përzgjedhjes

1. Për tu kualifikuar për procedurën e përzgjedhjes, Ofertuesit e interesuar duhet t'i plotësojnë kriteret objektive dhe të justifikueshme të cilat Autoriteti Kontraktues i konsideron të nevojshme për procedurën përkatëse, siç është përcaktuar në dokumentet e para-përzgjedhjes. Këto kritere duhet të përfshijnë së paku, si vijon:

1.1. Kualifikime adekuate teknike dhe profesionale, burime njerëzore, pajisje dhe objekte tjera fizike të nevojshme për sigurimin e suksesshëm të gjitha shërbimeve të nevojshme për fazat e projektit;

1.2. Kapacitet të mjaftueshëm për menaxhimin dhe përmbushjen e kushteve financiare të projektit; dhe

1.3. Aftësi të përshtatshme menaxheriale dhe organizative, qëndrueshmëri dhe përvojë, duke përfshirë përvojë paraprake në sigurimin e infrastrukturës ose shërbimeve të ngjashme.

2. Ofertuesit e interesuar kualifikohen për pjesëmarrje në procedurën e përzgjedhjes kur:

2.1. nuk i nënshtrohen procedurave të falimentimit, likuidimit, administrimit të kontrolluar ose ndërprerjes së veprimtarisë ose çfarëdo situatë tjetër e cila sipas ligjeve në fuqi shkakton inicimin e procedurave të kësaj natyre;

2.2. nuk janë shpallur fajtor për prodhimin e dokumenteve të falsifikuara.

Neni 25

Pjesëmarrja e Konsorciumeve

1. Autoriteti Kontraktues, kur së pari i fton Ofertuesit për pjesëmarrje në procedurën e përzgjedhjes, do tu lejojë atyre formimin e konsorciumeve ofertuese. Informatat që kërkohen nga

anëtarët e konsorciumeve ofertuese për ta dëshmuar kualifikimin e tyre sipas Nenit të mësipërm duhet të paraqiten si për konsorciumin në tërësi ashtu edhe për pjesëmarrësit individual.

2. Përveç nëse shprehimisht është përcaktuar ndryshe në dokumentet e para-përzgjedhjes, secili anëtar i një konsorciumi mund të marrë pjesë, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, vetëm në një konsorcium në të njëjtën kohë. Shkelja e kësaj rregulle do të shkaktojë përjashtimin e menjëhershëm të konsorciumit dhe të anëtarit individual.

3. Gjatë shqyrtimit të kualifikimeve të konsorciumeve ofertuese, Autoriteti Kontraktues do të merr parasysh aftësinë e secilit anëtar të konsorciumit dhe do të vlerësojë nëse kualifikimet e anëtarëve të konsorciumit janë të përshtatshme për përmbushjen e nevojave të të gjitha fazave të projektit.

Neni 26

Vendimi mbi para-përzgjedhjen

1. Autoriteti Kontraktues do të merr vendim lidhur me kualifikimet e secilit ofertues i cili ka paraqitur aplikacionin për para-përzgjedhje. Gjatë marrjes së këtij vendimi, Autoriteti Kontraktues do t'i përdorë vetëm kriteret e përcaktuara në dokumentet e para-përzgjedhjes. Të gjithë Ofertuesit e para-përzgjedhur më pas do të ftohen nga Autoriteti Kontraktues për paraqitjen e propozimeve të tyre në përputhje me nenet 27 deri 35 të këtij ligji.

2. Pavarësisht nga paragrafi i mësipërm, Autoriteti Kontraktues mundet, me kusht që në dokumentet e para-përzgjedhjes të ketë përfshirë një deklaratë për këtë qëllim, ta rezervojë të drejtën që pas përfundimit të procedurës së para-përzgjedhjes të kërkojë propozime vetëm nga një numër i kufizuar i Ofertuesve të para-përzgjedhur të cilët i plotësojnë më së miri kriteret e para-përzgjedhjes. Për këtë qëllim, Autoriteti Kontraktues do ti klasifikojë Ofertuesit të cilët i plotësojnë kriteret e para-përzgjedhjes në bazë të kriterëve të përdorura për vlerësimin e kualifikimeve të tyre si dhe do të përpilojë një listë të Ofertuesve të cilët do të ftohen për paraqitjen e propozimeve pas përfundimit të procedurës së para-përzgjedhjes. Gjatë përpilimit të listës, Autoriteti Kontraktues duhet të përdorë vetëm mënyrën e klasifikimit të përcaktuar në dokumentet e para-përzgjedhjes.

KREU III

Procedurat për Kërkimin e Propozimeve

Neni 27

Procedurat një-fazëshe dhe dy-fazëshe për kërkimin e propozimeve

1. Procedurat për kërkimin e propozimeve mund të zhvillohen në 1 ose 2 faza.

2. Pas pagimit të cilësdo takse e cila mund të aplikohet ose caktohet, autoriteti kontraktues do tu sigurojë ofertuesve të para kualifikuar specifikimet e tenderit dhe dokumentet përkatëse, në përputhje me nenin 28 të këtij ligji.

3. Pavarësisht nga sa u tha më sipër, autoriteti kontraktues mund të zhvillojë një procedurë dy-fazëshe për kërkimin e propozimeve nga ofertuesit e para-përzgjedhur, nëse elementet e projektit, si p.sh specifikimet e projektit, treguesit e performancës, aranzhimet financiare ose kushtet e kontratës nuk mund të përshkruhen në kërkesën për propozime në mënyrë të mjaft hollësishme ose të saktë për tu lejuar ofertuesve që t'i përgatisin propozimet e tyre përfundimtare.

4. Kur përdoret procedura dy-fazëshe, do të zbatohen këto dispozita:

4.1. kërkesa fillestare për propozime duhet të kërkojë nga Ofertuesit që në fazën e parë të procedurës të dorëzojnë propozimet e tyre fillestare lidhur me specifikimet e projektit, treguesit e performancës, kushtet financiare dhe karakteristikat tjera të projektit si dhe në lidhje me kushtet kryesore të kontratës të propozuara nga Autoriteti Kontraktues.

4.2. autoriteti kontraktues mund të thërrasë mbledhje dhe të zhvillojë diskutime me cilindo Ofertues për sqarimin e pyetjeve lidhur me kërkesën fillestare për propozime ose propozimet fillestare dhe dokumentet përcjellëse të dorëzuara nga Ofertuesit. Autoriteti kontraktues do të përgatisë procesverbalin e cilësdo mbledhje ose diskutimi të këtillë, i cili duhet të përmbajë pyetjet e parashtruara dhe sqarimet e dhëna nga Autoriteti Kontraktues;

4.3. pas shqyrtimit të propozimeve të pranuar, Autoriteti Kontraktues mund të shqyrtojë dhe, sipas nevojës, të ndryshojë kërkesën fillestare për propozime përmes fshirjes ose ndryshimit të cilitdo aspekt të specifikimeve fillestare të projektit, treguesve të performancës, kushteve të financimit ose karakteristikave tjera të projektit, duke përfshirë kushtet kryesore të kontratës si dhe cilindo iter për vlerësimin dhe krahasimin e propozimeve si dhe për përcaktimin e Ofertuesit të suksesshëm të përcaktuar në kërkesën fillestare për propozime, si dhe të shtojë karakteristika ose kritere. Autoriteti kontraktues në procesverbalin e procedurës së zgjedhjes duhet të përfshijë arsyetimet për çfarëdo ndryshimi të kërkesës për propozime. Çdo fshirje, ndryshim ose plotësim i këtillë duhet të theksohet në ftesën për dorëzimin e propozimeve përfundimtare;

4.4. në fazën e dytë të procedurës, Autoriteti Kontraktues i fton ofertuesit që ti dorëzojnë propozimet e tyre përfundimtare lidhur me një grup të vetëm të specifikimeve të projektit, treguesve të performancës ose kushteve të kontratës, sipas neneve 28 deri 35 të këtij ligji.

Neni 28

Përmbajtja e kërkesës për propozime

1. Kërkesa për propozime do të përmbajë së paku këto të dhëna:

- 1.1. informatat e përgjithshme të cilat mund të kërkohen nga Ofertuesit për përgatitjen dhe dorëzimin e propozimeve, duke përfshirë informatat mbi afatet për dorëzimin e propozimeve;
- 1.2. specifikimet e projektit dhe treguesit e performancës, sipas rastit, duke përfshirë kushtet e Autoritetit Kontraktues mbi standardet e sigurisë dhe sigurimit si dhe mbrojtjen e mjedisit;
- 1.3. kushtet e kontratës të propozuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë një përcaktim të kushteve të cilat konsiderohen të pa negociueshme;
- 1.4. kriteret për vlerësimin e propozimeve dhe pragjet, nëse ka të tillë, të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues për identifikimin e propozimeve të papërgjegjshme; peshën relative e cila i është dhënë secilin kriter të vlerësimit; dhe mënyrën në të cilën kriteret dhe pragjet do të aplikohen për vlerësimin dhe refuzimin e propozimeve.

Neni 29 **Siguria e Ofertës**

1. Kërkesa për propozime duhet të përcaktojë kushtet lidhur me dhënësin dhe natyrën, formën, shumën dhe kushtet e tjera themelore për sigurinë e kërkuar të ofertës.
2. Ofertuesit nuk i konfiskohet siguria e kërkuar e tenderit, përveç në rast të:
 - 2.1. tërheqjes ose ndryshimit të propozimit pas skadimit të afatit për dorëzimin e propozimeve;
 - 2.2. mos hyrjes në negociatat përfundimtare me Autoritetin Kontraktues sipas paragrafi 1 të nenit 35 të këtij ligji;
 - 2.3. mos paraqitjes së ofertës së tij më të mirë dhe përfundimtare brenda afatit kohor të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues sipas paragrafi 2 të nenit 35 të këtij ligji;
 - 2.4. mos nënshkrimit të Marrëveshjes, pasi që kjo të jetë kërkuar nga Autoriteti Kontraktues, pas pranimit të propozimit;
 - 2.5. mos ofrimit të sigurisë së kërkuar për përmbushjen e Marrëveshjes pas pranimit të propozimit ose mos plotësimit të cilitdo kusht tjetër të përcaktuar në kërkesën për propozime para nënshkrimit të Marrëveshjes.

Neni 30

Sqarimet dhe ndryshimet

1. Autoriteti Kontraktues mundet, qoftë me vetiniciative ose pas kërkesës për sqarime nga një Ofertues, ta shqyrtojë dhe, sipas rastit, ta ndryshojë cilindo element të kërkesës për propozime.
2. Çdo ndryshim duhet tu komunikohet të gjithë kandidatëve të cilët i kanë porositur dokumentet. Nëse Autoriteti Kontraktues e konsideron të nevojshme që t'i ndryshojë dokumentet dhe kur kjo bëhet pas skadimit të dy të tretave (2/3) ose më shumë të periudhës kohore për përgatitjen e ofertave, atëherë Autoriteti Kontraktues e shtyn afatin kohor për dorëzimin e ofertave për një të tretën (1/3) të periudhës origjinale.
3. Në procesverbalin e procedurës së përzgjedhjes, Autoriteti Kontraktues duhet të paraqesë arsyetimet për çfarëdo ndryshimi të kërkesës për propozime. Të gjitha fshirjet, ndryshimet ose plotësimet e këtilla duhet tu komunikohen Ofertuesve në të njëjtën mënyrë si kërkesa për propozime.

Neni 31

Dorëzimi i propozimeve

Ofertuesit do t'i dorëzojnë propozimet e tyre në formë të shkruar, të nënshkruara dhe të vëna në zarfe të vulosura. Propozimi i pranuar nga Autoriteti Kontraktues pas afatit të fundit për dorëzim të propozimeve, nuk do të hapet dhe do ti kthehet Ofertuesit që e ka dorëzuar atë.

Neni 32

Kriteret e vlerësimit

1. Kriteret për vlerësimin dhe krahasimin e propozimeve teknike do të përfshijnë të paktën me sa vijon:
 - 1.1. saktësinë teknike;
 - 1.2. pajtueshmërinë me standardet mjedisore;
 - 1.3. realizueshmërinë operationale dhe efektshmërinë; dhe
 - 1.4. cilësinë e shërbimeve dhe masave për të siguruar vazhdimësinë e tyre;
2. Kriteret për vlerësimin dhe krahasimin e propozimeve financiare dhe komerciale do të përfshijnë, kur është e përshtatshme:
 - 2.1. vlerën e tanishme të tarifave të propozuara, çmimet për njësi dhe ngarkesat tjera gjatë periudhës së Marrëveshjes;

- 2.2. vlerën e tanishme të pagesave të drejtpërdrejta të propozuara nga Autoriteti Kontraktues, nëse ka të tilla;
- 2.3. koston për aktivitetet e dizajnit dhe ndërtimit, koston e operimit dhe mirëmbajtjes vjetore, vlerën e tanishme të koston kapitale dhe të koston së operimit dhe mirëmbajtjes;
- 2.4. shtrirjen e përkrahjes ekonomike, nëse ka të tillë, që pritet nga Autoriteti Publik;
- 2.5. qëndrueshmërinë dhe zbatueshmërinë e aranzhimeve financiare të propozuara;
- 2.6. shtrirjen e pranimit të kushteve kontraktuese të negociueshme, të propozuara nga Autoriteti Kontraktues në kërkesën për propozime; dhe/ose
- 2.7. potencialin e zhvillimit ekonomik dhe social të ofruar nga propozimet

Neni 33

Krahasimi dhe vlerësimi i propozimeve

1. Autoriteti Kontraktues do të krahasojë dhe vlerësojë secilin propozim në përputhje me kriteret e vlerësimit, peshën relative të dhënë secilit prej atyre kriterëve dhe procesin e vlerësimit, të shprehur në kërkesën për propozime.
2. Për qëllimet e përmendura më sipër, Autoriteti Kontraktues mund të përcaktojë pragjet minimale sa i përket cilësisë, dhe aspekteve teknike, financiare e komerciale. Propozimet që nuk i përmbushin këto pragje minimale do të konsiderohen jo të përgjegjshme dhe do të diskualifikohen.

Neni 34

Demonstrimi i mëtejme i përmbushjes së kriterëve për kualifikim

Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë nga cilindo Ofertues që është para-përzgjedhur, për të demonstruar sërish kualifikimet e tij në përputhje me kriteret e njëjta të përdorura për para-përzgjedhjen. Autoriteti Kontraktues do të diskualifikojë cilindo Ofertues që nuk demonstroi sërish kualifikimet e tij, nëse atij i kërkohet kjo.

Neni 35

Negociatat finale

1. Autoriteti Kontraktues do të klasifikojë të gjitha propozimet e përgjegjshme në bazë të kriterëve të vlerësimit, dhe do të ftojë për negociim final të Marrëveshjes Ofertuesin që ka arritur klasifikimin më të mirë.

2. Negociatat finale nuk do të merren me ato kushte kontraktuese, nëse ka të tilla, që janë deklaruar si të pa negociueshme në kërkesën finale për propozime.

3. Nëse bëhet e qartë për Autoritetin Kontraktues që negociatat me Ofertuesin e ftuar nuk do të rezultojnë në Marrëveshje brenda një afati të arsyeshëm kohor, Autoriteti Kontraktues do informojë Ofertuesin për qëllimin e tij të dhënies fund negociatave dhe do ti japë Ofertuesit afat prej tridhjetë (30) ditësh për të formuluar ofertën e tij më të mirë dhe finale. Nëse Autoriteti Kontraktues nuk e konsideron të pranueshëm atë propozim, do tu jap fund negociatave me Ofertuesin në fjalë dhe do të ekzekutojë garancitë korresponduese. Autoriteti Kontraktues do të ftojë më pas për negociata Ofertuesit tjerë, sipas renditjes së klasifikimit të tyre, deri në arritjen e Marrëveshjes apo deri në refuzimin e të gjitha propozimeve të mbetura. Autoriteti Kontraktues nuk do të rifillojë negociatat me Ofertuesin me të cilin negociatat janë ndërprerë në përputhje me këtë paragraf.

KREU IV

Negocimi i Marrëveshjeve pa procedura konkurruese

Neni 36

Rrethanat që autorizojnë dhënien e kontratës pa procedura konkurruese

1. Në varësi të aprovimit në instancë të parë nga PPP-KDNM dhe në instancë të dytë, nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Autoriteti Kontraktues është i autorizuar të negociojë Marrëveshjen pa shfrytëzuar procedurat e përcaktuara në nenet 23 deri në 35 të këtij ligji në këto instanca:

1.1. kur ekziston nevoja urgjente për sigurim të vazhdimësisë në ofrimin e shërbimit dhe hyrja në procedurat konkurruese të përcaktuara në nenet 23 deri në 35 të këtij ligji do të ishte jopraktike, me kusht që rrethanat që kanë shkaktuar urgjencën nuk kanë qenë të parashikueshme nga Autoriteti Kontraktues dhe nuk janë rezultat i sjelljes së ngadalshme nga ana e tij;

1.2. kur projekti përfshin çështje që kanë të bëjnë me sigurinë publike;

1.3. në rastet tjera kur Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik autorizon një përjashtim të tillë për shkaqe bindëse të interesit publik.

2. Kohëzgjatja e Marrëveshjes, e nënshkruar sipas nën-paragrafit 1.1. të paragrafit 1. të këtij neni, nuk do të jetë më e gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj.

Neni 37
Procedurat për negociim të marrëveshjeve

1. Kur Marrëveshja negociohet pa shfrytëzim të procedurave konkurruese të tenderit, të përcaktuara në nenet 23 deri në 34, Autoriteti Kontraktues:

1.1. përveç për Marrëveshjet e negociuara në pajtim me nën-paragrafin 1.2. të nenit 36 të këtij ligji, do të njoftojë qëllimin e tij për nisje të negociatave në lidhje me Marrëveshjen, që do të publikohet në përputhje me dispozitat relevante të Ligjit të Prokurimit Publik;

1.2. do të angazhohet në negociata me po aq persona sa Autoriteti Kontraktues i gjykon si të aftë për zbatim të projektit ashtu si e lejojnë rrethanat;

1.3. do të përcaktojë kriteret e vlerësimit kundrejt të cilave do të vlerësohen dhe klasifikohen propozimet.

KREU V
Propozimet e pa kërkuara

Neni 38
Pranueshmëria e propozimeve të pa kërkuara

Autoriteti kontraktues është i autorizuar të shqyrtojë dhe të pranojë propozimet e pa kërkuara në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenet 39 deri në 40 të këtij ligji, me kusht që ato propozime të mos jenë në lidhje me ndonjë projekt për të cilin procedurat e përzgjedhjes janë iniciuar apo shpallur.

Neni 39
Procedurat për konstatim të pranueshmërisë së propozimeve të pa kërkuara

1. Në afat prej nëntëdhjetë (90) ditësh nga pranimi dhe shqyrtimi i propozimit të tillë të pa kërkuar, Autoriteti Kontraktues do të konstatojë nëse projekti konsiderohet në jetë në interes publik dhe për këtë qëllim do të informojë propozuesin.

2. Nëse projekti konsiderohet që mund të jetë potencialisht në interes publik, Autoriteti Kontraktues do të ftojë propozuesin për të dorëzuar sa më tepër informata që është e mundur lidhur me projektin e propozuar, për të mundësuar Autoritetit Kontraktues vlerësimin e duhur të kualifikimeve të propozuesit dhe të realizueshmërisë teknike e ekonomike të projektit, dhe për të konstatuar nëse projekti ka mundësi të implementohet me sukses në mënyrën e propozuar, sipas kushteve të pranueshme për Autoritetin Kontraktues. Për këtë qëllim, propozuesi do të dorëzojë në afat prej njëqindnjëzet (120) ditësh nga kërkesa e bërë prej Autoritetit Kontraktues, studimin e realizueshmërisë teknike dhe ekonomike, studimin e ndikimit mjedisor, dhe informata të kënaqshme sa i përket konceptit apo teknologjisë së parashikuar në propozim.

3. Në shqyrtimin e propozimit të pa kërkuar, Autoriteti Kontraktues do të respektojë pronën intelektuale, sekretet tregtare apo të drejtat tjera ekskluzive që i përmban, që dalin nga apo që referohen në propozim. Autoriteti Kontraktues nuk do të shfrytëzojë informatat e siguruara nga apo në emër të propozuesit në lidhje me propozimin e tij të pa kërkuar, pa marrë pëlqimin e propozuesit, për një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muajsh nga pranimi i tij.

Neni 40

Inicimi i procedurës së përzgjedhjes

1. Në afat prej gjashtë (6) muajsh nga pranimi i dokumentacionit të përcaktuar në paragrafin 2. të nenit 39 të këtij ligji, Autoriteti Kontraktues do të vendosë formalisht nëse do të pranojë apo do të refuzojë projektin potencial të përfutur nga propozimi i pa kërkuar. Nëse propozimi i pa kërkuar pranohet nga Autoriteti Kontraktues, atëherë Autoriteti Kontraktues, kur është e përshtatshme, së pari do të kërkojë autorizimin nga KDNM-PPP të caktuar në paragrafin 5 të nenit 18 të këtij ligji për të vazhduar drejt tenderit dhe pas aprovimit do të iniciojë procedurën konkurruese të përzgjedhjes në përputhje me nenet 23 deri në 35 të këtij ligji. Në raste se propozimi refuzohet qoftë nga Autoriteti Kontraktues dhe/ose nga KDNM-PPP dhe palët nuk pajtohen ndryshe, Autoriteti Kontraktues do të kthejë propozuesit origjinalin dhe kopjet eventuale të dokumenteve të cilat propozuesi i ka dorëzuar dhe përgatitur gjatë procedurës.

2. Propozuesi do të ftohet për të marrë pjesë në procedurë konkurruese të përzgjedhjes, të iniciuar në përgjigje ndaj kërkesës së tij të pa kërkuar, dhe me vendim të Autoritetit Kontraktues, do të epet bonus në pikët e tij teknike dhe/apo financiare gjatë procedurës konkurruese të përzgjedhjes, deri në maksimumin prej 10% të pikëve. Identiteti i propozuesit dhe ekzistenca dhe shuma e bonusit do të bëhet me dije në dokumentet e procedurës konkurruese të përzgjedhjes.

KREU VI

Dispozitat e ndryshme

Neni 41

Konfidencialiteti

Autoriteti Kontraktues do të trajtojë propozimet në atë mënyrë që të shmangë zbulimin e përmbajtje së tyre për Ofertuesit konkurrues. Cilat do diskutime, komunikime dhe negociata ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe cilitdo Ofertues, do të jenë konfidenciale. Përveç nëse kërkohet me ligj apo me urdhër të gjykatës, apo nëse lejohet nga kërkesa për propozime, asnjë palë në negociata nuk do të bëjë të ditura për cilindo person tjetër, cilëndo informatë teknike, për çmimet, apo informata të tjera në lidhje me diskutimet, komunikimet dhe negociatat në përputhje me dispozitat e sipërpërmendura, pa pëlqimin e palës tjetër.

Neni 42
Njoftimi për dhënie të kontratës

Përveç për Marrëveshjet e dhëna në përputhje me nën-paragrafit 1.2. të paragrafit 1. të nenit 36 të këtij ligji, Autoriteti Kontraktues do të publikojë njoftimin për dhënie të kontratës në përputhje me dispozitat relevante të Ligjit të Prokurimit Publik. Njoftimi do të identifikojë Partnerin privat dhe do të përfshijë përmbledhjen e kushteve esenciale të Marrëveshjes.

Neni 43
Regjistrimi i procedurave të përzgjedhjes dhe dhënies së kontratës

Autoriteti Kontraktues do të mbajë shënime të duhura për informatat që kanë të bëjnë me procedurat e përzgjedhjes dhe dhënies së kontratës, në përputhje me dispozitat e Ligjit të Prokurimit Publik.

Neni 44
Procedurat e rishikimit

Ofertuesi që pretendon se ka pësuar apo që mund të pësojë humbje apo dëmtim për shkak të shkeljes së detyrimit të parashikuar me ligj për Autoritetin Kontraktues, mund të kërkojë rishikimin e veprimeve apo mosveprimeve të Autoritetit Kontraktues në përputhje me dispozitat relevante të Ligjit të Prokurimit Publik.

TITULLI V

MARRËVESHJA PËR PPP

PJESA 1
Përmbajtja dhe dispozitat e përgjithshme

Neni 45
Ligji i zbatueshëm

1. Marrëveshja do të rregullohet nga ligji i Republikës së Kosovës.
2. Partneri privat, aksionarët e tij, dhe partnerët tjerë të biznesit, do të jenë të lirë të zgjedhin ligjin me të cilin rregullohen raportet e tyre.

Neni 46

Përmbajtja e marrëveshjes

1. Marrëveshja do të përcaktojë çështjet që konsiderohen të përshtatshme nga palët, sikur që është:

1.1. natyra dhe shtrirja e punëve që do të kryhen dhe shërbimet që do të ofrohen nga Partneri privat;

1.2. kushtet për ofrimin e atyre shërbimeve dhe shtrirja e ekskluzivitetit, nëse ka të tillë, të të drejtave të Partnerit Privat me Kontratë;

1.3. asistenca që Autoriteti Kontraktues mund ta sigurojë për Partnerin Privat në marrjen e licencave dhe lejeve në masën e nevojshme për implementim të projektit;

1.4. shtrirja në të cilën Partneri Privat do të autorizohet të bëjë nën-kontraktimin e shërbimeve që duhet ti ofrojë në përputhje me Marrëveshjen;

1.5. kërkesat eventuale që lidhen me themelimin dhe kapitalin minimal të entitetit ligjor të inkorporuar në përputhje me nenin 52 të këtij ligji;

1.6. pronësia mbi asetet që lidhen me projektin dhe obligimet e palëve, ashtu si shihet e përshtatshme, lidhur me përvetësimin e lokacionit të projektit dhe lehtësimet e nevojshme eventuale, në përputhje me nenet 47 deri në 49 të këtij ligji;;

1.7. pagesa për Partnerin privat, qoftë në formë të tarifave apo ngarkesave për shfrytëzim të lehtësirave apo për ofrim të shërbimeve; metodat dhe formulat për themelimin dhe përshtatjen e tarifave apo ngarkesave të tilla; dhe pagesat, nëse ka të tilla, që mund të bëhen nga Autoriteti Kontraktues apo nga Autoriteti Publik;

1.8. procedurat për rishikim dhe aprovim të dizajneve të projektimit, planeve të ndërtimit dhe specifikimeve nga Autoriteti Kontraktues, dhe procedurat për testim dhe inspektim final, aprovim dhe pranim të objektit të infrastrukturës;

1.9. shtrirja e obligimeve të Partnerit privat, për të siguruar, ashtu si shihet e përshtatshme, modifikimin e shërbimit për të plotësuar kërkesën reale për shërbimet, vazhdimësinë e tij dhe ofrimin e tij nën të njëjtat kushte për të gjithë shfrytëzuesit;

1.10. e drejta e Autoritetit Kontraktues apo e Autoritetit tjetër Publik për monitorim të punëve dhe shërbimeve që do të ofrohen nga Partneri privat dhe i kushteve dhe shtrirjes në të cilën Autoriteti Kontraktues apo Autoriteti tjetër Publik i autorizuar, mund të urdhërojë ndryshime sa u përket punëve dhe kushteve të shërbimit apo të ndërmarrë veprime të tjera të arsyeshme që konsiderohen të përshtatshme, për të siguruar që objekti i infrastrukturës është duke operuar si duhet dhe që shërbimet janë duke u ofruar në përputhje me kërkesat e zbatueshme ligjore dhe kontraktuese;

1.11. shtrirja e obligimit të Partnerit privat për të siguruar për Autoritetin Kontraktues apo Autoritetin tjetër Publik, raporte dhe informata të tjera për operacionet e tij;

1.12. mekanizmat për trajtim të kostos shtesë dhe pasojave të tjera që mund të rezultojnë nga cilido urdhër i lëshuar nga Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Publik, në lidhje me nën-paragrafët 1.9. dhe 1.10. të këtij paragrafi, përfshirë këtu kompensimin eventual në të cilin mund të ketë të drejtë Partneri privat;

1.13. në masën që konsiderohet e nevojshme, cilat do të drejta të Autoritetit Kontraktues për rishikim dhe aprovim të kontratave të mëdha që do të lidhen nga Partneri privat, në veçanti me aksionarët e Partnerit privat apo personat tjerë të bashkuar me të;

1.14. garancitë e performansës që do të ofrohen dhe politikat e sigurimit që do të mbahen nga Partneri privat në lidhje me implementimin e projektit;

1.15. mjetet që do të jenë në dispozicion në rast të mosplotësimit të zotimeve nga cilado palë;

1.16. shtrirja në të cilën cilado nga palët mund të përjashtohet nga përgjegjësia për dështim apo vonesë në plotësimin e cilitdo obligim sipas Kontratës, për shkak të rrethanave që janë jashtë kontrollit të arsyeshëm;

1.17. kohëzgjatja e Kontratës dhe të drejtat e detyrimet e palëve me skadimin apo dhënien fund të kontratës;

1.18. mënyra për kalkulim të kompensimit në rast të përfundimit të parakohshëm;

1.19. ligji qeverisës dhe mekanizmat për zgjidhjen e kontesteve që mund të shfaqen ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Partnerit Privat;

1.20. të drejtat dhe detyrimet e palëve në lidhje me informatat konfidenciale.

1.21. Identifikimi i institucioneve dhe /apo personelit me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për mbikëqyrje dhe monitorim të kontratës.

Neni 47 **Pronësia mbi asetet**

1. Marrëveshja do të specifikojë cilat asete janë apo do të jenë pronë në pronësi publike, dhe cilat asete janë apo do të jenë pronë private e Partnerit privat. Kontrata në veçanti do të identifikojë cilat asete u takojnë kategorive në vijim:

1.1. Asetet që Partneri privat kërkohet ti kthejë apo transferojë tek Autoriteti Kontraktues apo tek një entitet tjetër të treguar nga Autoriteti Kontraktues, në përputhje me kushtet e Marrëveshjes;

1.2. Asetet që Autoriteti Kontraktues, sipas zgjedhjes së tij, mund ti blejë nga Partneri privat; dhe

1.3. Asetet që Partneri privat mund ti mbajë apo ti sistemojë pas skadimit apo dhënies fund të Marrëveshjes.

Neni 48

Përvetësimi i të drejtave që lidhen me lokacionin e projektit

Autoriteti Kontraktues apo Autoriteti tjetër Publik, ashtu si parashihet me ligj dhe me Marrëveshjen, do të vë në dispozicion të Partnerit privat, apo kur është e përshtatshme, do të ndihmojë Partnerin privat në sigurimin e të drejtave që lidhen me lokacionin e projektit, përfshirë këtu të drejtën e shfrytëzimit, ashtu si shihet e nevojshme për implementim të projektit.

Neni 49

Lehtësimet

1. Partneri privat do të ketë të drejtë të hyjë, të kalojë përmes pronës së palëve të treta, për të kryer punë apo për të rregulluar instalimet, ashtu si është e përshtatshme dhe e nevojshme për implementim të projektit, në përputhje me dispozitat e ligjit të zbatueshëm për të drejtat pronësore.

2. Cilat do lehtësime që mund të kërkohen për implementim të projektit do të krijohen në përputhje me ligjin e zbatueshëm për të drejtat pronësore.

Neni 50

Operimi i infrastrukturës

1. Marrëveshja do të përcaktojë, ashtu si shihet e përshtatshme, shtrirjen e obligimeve të Partnerit privat, për të siguruar:

1.1. Modifikimin e shërbimit për të plotësuar kërkesën për shërbim;

1.2. Vazhdimësinë e shërbimit;

1.3. Ofrimin e shërbimit esencialisht nën të njëjtat kushte për të gjithë shfrytëzuesit;

1.4. Qasjen jo diskriminuese, të ofruesve të tjerë të shërbimeve në cilindo rrjet të infrastrukturës publike të operuar nga Partneri privat.

2. Partneri privat do të ketë të drejtë të nxjerrë dhe të zbatojë rregulla për shfrytëzimin e hapësirave, me aprovim nga Autoriteti Kontraktues apo cilido Autoritet tjetër publik i autorizuar.

Neni 51

Dispozitat financiare

1. Partneri privat do të ketë të drejtë të ngarkojë, të marrë apo të mbledhë tarifa apo ngarkesa për shfrytëzimin e hapësirave apo shërbimeve të tij, në përputhje me Marrëveshjen, që do të përcaktojë metodat dhe formulat për themelim dhe përshtatje të atyre tarifave apo ngarkesave, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Autoriteti publik kompetent.
2. Kur është e zbatueshme, Marrëveshja do të identifikojë shprehimisht afatet dhe kushtet e të gjitha pagesave, garancive, subvencioneve apo përkrahjes tjetër financiare që do të sigurohet nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 52

Organizimi i Partnerit privat

Autoriteti kontraktues do të kërkojë që Ofertuesi i suksesshëm të themelojë entitetin e pavarur ligjor të inkuorporuar sipas ligjeve të Kosovës, para formalizimit të Marrëveshjes. Cilado kërkesë që lidhet me kapitalin minimal të atij entiteti ligjor dhe procedurat për sigurim të aprovimit nga Autoriteti Kontraktues për statutin dhe aktet nënligjore të tij, si dhe për ndryshimet e konsiderueshme në të, do të përcaktohet në Marrëveshje, në mënyrë konsistente me kushtet e kërkesës për propozime.

Neni 53

Bartja e interesit kontrollues në Partnerin privat

Përveç nëse parashihet ndryshe në Marrëveshje, interesi kontrollues në Partnerin privat mund të mos bartet tek palët e treta pa pëlqimin e Autoritetit Kontraktues. Marrëveshja do të përcaktojë kushtet nën të cilat do të ipet pëlqimi i Autoritetit Kontraktues.

Neni 54

Interesat e sigurimit

1. Varësisht nga kufizimi eventual që mund të jetë pjesë e Marrëveshjes, Partneri privat ka të drejtë të krijojë interesa të sigurimit mbi cilindo nga asetet e tij, të drejtat apo interesat, përfshirë këtu ato që lidhen me Projektin e Infrastrukturës, që kërkohen për të siguruar financimin e nevojshëm për projektin.
2. Aksionarët e Partnerit privat do të kenë të drejtë të zotojnë apo të krijojnë çfarëdo interesi tjetër të sigurimit në aksionet e tyre në Partnerin privat.
3. Asnjë sigurim sipas paragrafit 1 të këtij neni, nuk mund të krijohet mbi pronën publike apo pronën tjetër, asetet apo të drejtat që nevojiten për ofrim të shërbimeve publike, kur krijimi i atij sigurimi është i ndaluar me ligjin e zbatueshëm.

Neni 55

Bartja e marrëveshjes

Përveç ashtu si parashihet me nenin 54 të këtij ligji, të drejtat dhe detyrimet e Partnerit privat sipas Marrëveshjes, nuk mund tu barten palëve të treta pa pëlqimin e Autoritetit Kontraktues. Marrëveshja do të përcaktojë kushtet nën të cilat Autoriteti Kontraktues do të japë pëlqimin e tij për bartje të të drejtave dhe detyrimeve të Partnerit privat sipas Marrëveshjes, përfshirë këtu pranimin nga Partneri i ri privat të të gjitha detyrimeve përkatëse dhe dëshmime për mundësitë teknike dhe financiare të Partnerit të ri privat, të nevojshme për ofrimin e shërbimit.

Neni 56

Ndryshimi i ligjit

Marrëveshja do të përcaktojë shtrirjen në të cilën Partneri privat ka të drejtë në kompensim në rast se kostoja për Partnerin privat për kryerjen e obligimeve që rrjedhin nga Marrëveshja është rritur në mënyrë të konsiderueshme, apo në rast se vlera që Partneri privat merr për atë përmbushje është zvogëluar në masë të konsiderueshme si rezultat i ndryshimeve në legjislacion apo në rregulloret që zbatohen në mënyrë specifike për objektin e infrastrukturës apo shërbimet që ofron ai.

Neni 57

Rishikimi i Marrëveshjes

1. Pa paragjykuar nenin 56, Marrëveshja do të përcaktojë masën në të cilën Partneri privat ka të drejtë të kërkojë bërjen e përshtatjeve në Marrëveshje, me qëllim të sigurimit të kompensimit në rast se kostoja e përmbushjes së Marrëveshjes nga Partneri privat është rritur në masë të konsiderueshme, apo nëse vlera që Partneri privat merr për atë përmbushje është zvogëluar në masë të konsiderueshme si rezultat i:

1.1. ndryshimeve në rrethanat ekonomike apo financiare; apo

1.2. ndryshimeve në legjislacion apo në rregulloret që zbatohen në mënyrë specifike për objektin e infrastrukturës apo shërbimet që ofron ai;

Me kusht që ndryshimet ekonomike, financiare, legjislative, apo rregullative:

1.1. Të shfaqen pas formalizimit të Marrëveshjes;

1.2. Janë jashtë kontrollit të Partnerit privat; dhe

1.3. Janë të asaj natyre që nuk ka qenë e mundur të pritet nga Partneri privat që ti ketë marrë parasysh në kohën e negocimit të Marrëveshjes, apo të ketë pasur mundësinë e shmangies apo tejkalimit të pasojave të tyre.

2. Marrëveshja do të përcaktojë procedurat për rishikim, ndryshim dhe modifikim të kushteve të Marrëveshjes.

Neni 58 **Ndërhyrja e Autoritetit Kontraktues**

Në rrethanat e përcaktuara në Marrëveshje, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë përsipër përkohësisht operimin e institucionit me qëllim të sigurimit të ofrimit efektiv dhe të papenguar të shërbimit, në rast të dështimit serioz nga Partneri publik për përmbushje të obligimeve të tij dhe për të korrigjuar shkeljen brenda periudhës së arsyeshme kohore pas marrjes së vërejtjes nga Autoriteti Kontraktues për ta bërë këtë.

Neni 59 **Zëvendësimi i Partnerit Privat**

Në përputhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara në Marrëveshje, Autoriteti Kontraktues mund të pajtohet me entitetet që sigurojnë financimin për Projektin e Infrastrukturës, që të marrin masa për zëvendësimin e Partnerit privat me një entitet të ri të kualifikuar apo me personin e emëruar për të përmbushur Marrëveshjen ekzistuese, në rast të shkeljeve serioze nga Partneri privat apo ngjarjeve të tjera që përndryshe do të arsyetonin përfundimin e Marrëveshjes. Me përjashtim të projekteve që përfshijnë Punët Komunale, çdo zëvendësim i këtillë duhet të bëhet me miratimin paraprak të KDNM-PPP.

PJESA 2 **Kohëzgjatja, Zgjatja e Afatit dhe Dhënia Fund e Marrëveshjes**

KREU I **Kohëzgjatja dhe zgjatja e afatit**

Neni 60 **Kohëzgjatja dhe zgjatja e afatit të Marrëveshjes**

1. Marrëveshja do të përcaktojë shprehimisht kohëzgjatjen e saj, që në asnjë rast nuk do të kalojë limitet e vendosura në paragrafin 1. të nenit 8 të këtij ligji.
2. Autoriteti Kontraktues mund të pajtohet të bëjë zgjatjen e afatit të Marrëveshjes për një periudhë shtesë në pajtim me paragrafin 2. të nenit 8 të këtij ligji.
3. Duke iu nënshtruar autorizimit paraprak nga ana e KDNM-PPP, aty ku kërkohet, Autoriteti Kontraktues mund të pajtohet të bëjë zgjatjen e kohëzgjatjes së Marrëveshjes në këto rrethana:

3.1. vonesa në kompletim apo ndërprerjet e operimit për shkak të rrethanave që janë jashtë kontrollit të arsyeshëm të cilësdo nga palët;

3.2. suspendimi i projektit i shkaktuar nga aktet e Autoritetit Kontraktues apo autoriteteve të tjera publike; apo

3.3. rritja e kostos si rezultat i kërkesave të Autoritetit Kontraktues, që nuk kanë qenë fillimisht të parashikuara në Marrëveshje, nëse Partneri privat nuk do të ishte në gjendje që në mënyrë tjetër të kompensojë humbjet e pretenduara pa një zgjatje të tillë të afatit.

KREU II

Skadimi apo mbarimi i marrëveshjes

Neni 61

Skadimi i marrëveshjes

Përveç nëse ndërpritet më herët në pajtim me dispozitat e përmendura këtu, Marrëveshja do të përfundojë në fund të periudhës së specifikuar në Marrëveshje dhe rishikimet e saj.

Neni 62

Përfundimi i parakohshëm i marrëveshjes nga Autoriteti Kontraktues

1. Me aprovimin paraprak të KDNM-PPP, Autoriteti Kontraktues mund ti jap fund Marrëveshjes:

1.1. në rast se më nuk mund të pritët në mënyrë të arsyeshme që Partneri privat do të jetë në gjendje apo i gatshëm të përmbushë obligimet e tij, apo

1.2. për shkaqe të detyruese të interesit publik, me pagim të kompensimit ndaj Partnerit privat, sipas kushteve të kompensimit të përcaktuara në Marrëveshje.

Neni 63

Përfundimi i parakohshëm i marrëveshjes nga Partneri privat

1. Partneri privat nuk mund ti japë fund marrëveshjes, përveç se në rrethanat si më poshtë:

1.1. në rast të shkeljes materiale të Marrëveshjes nga Autoriteti Kontraktues apo Autoriteti tjetër publik;

1.2. nëse janë plotësuar kushtet për rishikim të Marrëveshjes sipas Nenit 57, paragrafi 1, por palët nuk kanë arritur pajtim për rishikim të Marrëveshjes; apo

1.3. nëse kostoja e përmbushjes së Marrëveshjes nga Partneri privat është rritur në masë të konsiderueshme, apo nëse vlera që Partneri privat merr për atë përmbushje është zvogëluar në masë të konsiderueshme si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve nga Autoriteti Kontraktues apo autoritetet tjera publike, dhe palët kanë dështuar në arritjen e pajtimit për mjetet e duhura juridike.

Neni 64

Përfundimi i parakohshëm për shkaqe të tjera

1. Cilado palë do të ketë të drejtë ti japë fund Marrëveshjes në rast se përmbushja e obligimeve të saj bëhet e pamundur për shkak të fuqisë madhore apo rrethanave që janë jashtë kontrollit të arsyeshëm të cilëndo palë.
2. Palët do të kenë gjithashtu të drejtë ti japin fund Marrëveshjes me pëlqim të dyanshëm.

KREU III

Aranzimet në rast të përfundimit apo skadimit të marrëveshjes

Neni 65

Kompensimi për shkak të dhënies fund marrëveshjes

Marrëveshja do të përcaktojë mënyrën e kalkulimit të kompensimit për cilëndo palë në rast të dhënies fund Marrëveshjes, duke mundësuar kur është e përshtatshme, kompensimin për vlerën reale të punëve të kryera sipas Marrëveshjes, kostos së shkaktuar apo humbjeve të pësuar nga cilado palë, përfshirë këtu, ashtu si shihet e përshtatshme, fitimet e humbura.

Neni 66

Masat e përfundimit dhe transferit

1. Marrëveshja do të përcaktojë:
 - 1.1. procedurat për transfer të aseteve në Autoritetin Kontraktues;
 - 1.2. kompensimin në të cilin mund të ketë të drejtë Partneri privat për transferin apo shitjen e aseteve Autoritetit Kontraktues apo Partnerit të ri privat;
 - 1.3. transferin e teknologjisë së nevojshme për operim të objektit;

1.4. përgatitjen e personelit të Autoritetit Kontraktues apo të Partnerit privat pasardhës për operim dhe mirëmbajtje të shërbimit;

1.5. ofrimin nga ana e Partnerit privat, të shërbimeve të vazhdueshme mbështetëse dhe resurseve, përfshirë këtu furnizimin me pjesë rezervë, nëse kërkohet, për një periudhë të arsyeshme pas transferit të objektit tek Autoriteti Kontraktues apo pasardhësi

PJESA 3

ZGJIDHJA E KONTESTEVE

Neni 67

Kontestet ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Partnerit privat

1. Kontestet eventuale ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Partnerit Privat zgjidhen në bazë të procedurave të pranuar nga palët me Kontratë për zgjidhjen e kontesteve.
2. Në rast që Kontrata nuk specifikon procedurat e zgjidhjes së kontestit, kontestet zgjidhen me marrëveshje të palëve ose nga gjykata kompetente.

Neni 68

Arbitrazhi

Në mesin e mekanizmave për zgjidhje të kontesteve, Marrëveshja mund të parashohë procedurat për arbitrazh ndërkombëtar, vendimi i të cilit do të jetë detyrues dhe përfundimtar për palët.

Neni 69

Kontestet që përfshijnë klientët apo shfrytëzuesit e objektit të infrastrukturës

Kur Partneri privat ofron shërbime për publikun apo operon me hapësirat e infrastrukturës me mundësi përdorimi nga publiku, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë nga Partneri privat themelimin e procedurave të thjeshtësuara dhe efektive për trajtim të pretendimeve të dorëzuara nga klientët apo shfrytëzuesit e objektit të infrastrukturës.

TITULLI VI PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË PROKURIMIT

Neni 70 Organi Shqyrtues i Prokurimit

1. Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) do të jetë përgjegjës për të siguruar implementimin e duhur të Titujve IV dhe V të këtij Ligji. Së këndejmi, OSHP do të ketë funksionet dhe kompetencat e njëjta sa i përket implementimit të këtij ligji, sikur me ato që lidhen me implementimin e Ligjit të Prokurimit Publik.
2. Procedura e caktuar në Ligjin e Prokurimit Publik në lidhje me procesin e ankesës dhe shqyrtimin e vendimeve administrative do të aplikohen në këtë Ligj.

TITULLI VII DISPOZITAT SHFUQIZUESE

Neni 71 Ligji në fuqi

Ky ligj shfuqizon Ligjin nr. 02/L, të datës 27 prill 2006 për procedurën e dhënies së koncesioneve.

Neni 72 Periudha transitore

1. Procedurat e vazhduara tenderuese

Dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me procedurat e prokurimit dhe autorizimet paraprake nga KDNM-PPP nuk do të vlejné për procedurat e tenderimit për Partneritetet-Publiko-Private të cilat materialisht janë avancuar në datën e shpalljes së këtij Ligji. KDNM-PPP do të përcaktoj cilat projekte janë “materialisht të avancuara” dhe me këtë do t’i përjashtoj nga autorizimi paraprak dhe procedurat e caktuara në këtë ligj, por nën asnjë rrethanë një projekt nuk do të mund të përjashtohet nga ky ligj përveç nëse:

- 1.1. ofertuesit potencial tashmë janë para-kualifikuar në pajtim me procedurat e caktuara në Ligjin e Prokurimit Publik ose në udhëzimet e prokurimit të caktuara nga ndonjë institucion ndërkombëtar financiar; ose
- 1.2. një kërkesë zyrtare për dokumentet e propozimeve është publikuar në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik.

2. Komitetet Ekzistuese Drejtuese të Projekteve

Në rast se në kohën e shpalljes së këtij Ligji, një Projekt PPP është duke u implementuar në mënyrë aktive nën udhëheqjen e një komiteti drejtues të projektit të caktuar nga qeveria dhe nëse komiteti drejtues i projektit në fjalë ka finalizuar një prokurim të hapur publik për angazhimin e një këshilltari të kualifikuar të transaksionit në datën e shpalljes së këtij ligji, komiteti ekzistues drejtues do të veproj si KDNM-PPP për të gjitha qëllimet që kanë të bëjnë me implementimin e Projektit deri sa të jepet kontrata e PPP në pajtim me këtë Ligj.

3. Marrëveshjet tanimë të nënshkruara

Ky ligj nuk do të zbatohet për kontratat e koncesioneve që tanimë janë nënshkruar para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Ato kontrata vetëm do të ripërtërihen, ndryshohen apo zgjerohen, në pajtim me këtë ligj.

Neni 73 Implementimi i ligjit

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe KDNM-PPP themelojnë dhe konsolidojnë Njësinë e PPP, e cila vepron në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Neni 74 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 03/ L-090
25 qershor 2009**

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI

